REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

VENDIM

Nr.3 datë 14/09/2020

"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN DHE PROPOZIMIN NË KUVENDIN E SHQIPËRISË TË PROJEKTLIGJIT "PËR INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS"

Në mbështetje të nenit 18, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

V E N D O S I:

I. Ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe propozimin në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit "Për institucionin e Presidentit të Republikës", bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor parlamentar "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës së ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues".

II. Grupi i punës përbëhet nga 3 deputetë, anëtarë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si më poshtë:

1. Vasilika Hysi
2. Adnor Shameti
3. Alban Zeneli

III. Grupi i punës do të asistohet në veprimtarinë e tij nga shërbimet e Kuvendit si dhe nga ekspertë të jashtëm.

IV. Drafti përfundimtar i projektligjit, me qëllim vazhdimin e procedurave parlamentare për depozitimin e tij, duhet të paraqitet në Komisionin për Çështjet Ligjore brenda datës 15.10.2020.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ULSI MANJA

Tiranë 14.9.2020